



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 11.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **10.07.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Construmax SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i QKMF ne Istog" me Nr. të Prok: 206-23-6380-5-1-2 nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Construmax SH.P.K** e dt. 10.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i QKMF ne Istog" me Nr. të Prok: 206-23-6380-5-1-2 kundër Njoftimit për kontratë të datës 27.06.2023 të publikuar ne platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** Njoftimi për kontratë i datës 27.06.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **Construmax SH.P.K** me date 10.07.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i QKMF ne Istog" me Nr. të Prok: 206-23-6380-5-1-2. Autoriteti Kontraktues, me datë 11.07.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas **Construmax SH.P.K**:

1. Neni 1 i LPP-së
2. Neni 7 i LPP-së
3. Neni 27 i LPP-së
4. Neni 28 i LPP-së
5. Neni 68 i LPP-së

6. Neni 69 i LPP-së
7. Neni 71 i LPP-së
8. Neni 17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
9. Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

#### **Pretendimi ankimor**

*Ne si palë e interesuar për të ofertuar në këtë projekt e kemi analizuar dosjen e tenderit në tërësi dhe njoftimin për kontratë, ndërsa kemi vërejtur se ju kemi vendosur kërkesa diskriminuese/favorizuese në dosje të tenderit, të cilat do të sqarojmë më poshtë:*

*Tek DT pjesa e Vlerësimi i aplikacioneve 22.3 Faktorët të cilët do të merren në konsideratë gjatë rikzaminimit janë:*

- i. Numri më i madh i kontratave me vlerë të madhe (mbi 500,000 Euro) të përfunduara me sukses, që plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik të përmendur nën pikën 8.1 më sipër;*
- ii. Numri më i madh i kontratave për ndërtimin e projekteve shëndetësorë të kategorisë QKMF ose më lartë (nuk përfshihen AMF ambulancat).*

*Shënim: fillimisht zbatohet pika (i) dhe pastaj (ii) zbatohet në rast se dy ose më shumë operatorë ekonomik kanë të njëjtin numër kontratash të përfunduara me sukses sipas pikës (i).*

*Ne konsiderojmë që ky faktor është konfuz dhe është diskriminues pasi kontratat me vlera të mëdha janë kontrata që parashikimi i tyre mund të jete mbi vlerën e parashikuar mbi 500,000 euro mirëpo nuk do të thotë oferta të jete mbi këtë vlerë, ku ne kemi disa raste që kontratat kanë qene të planifikuara mbi vlerën 500 mijë euro me nr prokurimi 511 mirëpo ofertat tona kanë qene nën vlerën 500 mijë euro dhe kemi përfunduar punimet dhe posedojmë referenca për to, ku kemi edhe me juve si ministri. Gjithashtu ky faktor edhe nuk e precizon se këto referenca a duhet të jene brenda 3 viteve të fundi. Duke u bazuar në këtë Vlerësim të aplikacioneve përpos që është kufizuar në objekte të kategorisë si QKMF, ky është kufizuar edhe në vlerën e kontratave që kanë shumën mbi 500, 000 euro ku është në kundërshtim me nenin 69 të LPP-se citojmë paragrafin 4.2*

*listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënenshkruara nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;*

*Bazuar në LPP-ne , Rregulloren N.001/2022 dhe Udhëzuesin Nr-001/2023, konsiderojmë që vendosja e këtij faktori përcaktues për kualifikim të OE, duke kushtëzuar vlerën e sakte për referencave është në kundërshtim me ligjin, rregulloren dhe udhëzuesin e lartë cekur, pasi që mund të jete i faktor për favorizimin e ndonjë OE.*

*Andaj kërkojmë nga ju si AK të korrigjoni këtë faktor kualifikimi pas që është në kundërshtim me LPP-ne, Rregulloren N.001/2022 dhe Udhëzuesin Nr-001/2023 dhe të vendoset sipas ligjit që faktori kualifikues të jete numri me i madhe i kontratave në vlerë të mëdha me nr të prokurimit që përfundojnë me 511 apo kërkesa të jete për shumën e referencave bashkërisht në vlerë 500,000 euro siç e përcakton neni 69 i LPP-se.*

*Gjithashtu supozojmë që vendosja e këtij faktori për kualifikim është bere me qellim, dhe dyshojmë që është vendosur vetëm e vetëm që ne si OE të mos marrim pjesë, pasi që ne jemi OE që kemi kontrata në vazhdimësi me juve si AK, mirëpo kontratat e përfunduara që kanë qene kontrata në vlera të mëdha nuk janë nën vlerën 500 mijë euro, dhe kontrata e cila është e kontraktuar me ju dhe ka vlerën mbi 500 mijë edhe në proces të pranimit teknik dhe duke e ditur referencat e kompanisë tone, supozojmë që është vendosur ky kriter-faktor për të na pamundësuar kualifikimin.*

Bazuar ne përvojën qe kemi, dallimi ne mes QKMF-ve dhe AMF-ve është kryesisht tek pjesa e gazit medicinal dhe rrezatimit X-ray, dhe nuk do te kishte ndonjë specifik qe duhet te jene patjetër ne vlerën prej 500,000 euro, pasi qe vlera e përcaktuar nuk mund te ketë ndonjë kushte profesional mirëpo vetëm kushte diskriminues

Kërkesat e lartcekura bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Me këtë kërkesë, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit".

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me qëllimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Me kërkesat e vendosura nga ju, jo që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik por OE të themeluara rishtazi i janë mbyllur plotësisht dyert dhe mundësitë e ofertimit. Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (që ju kanë përshtat kriteret) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventualisht të nënshkruajnë kontratë, prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshtaten kërkesat është shumë e madhe.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 17.17 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që "Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".

Pra duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë, shihet tendenca juaj për dhënien e kontratës operatorëve ekonomik të caktuar, pasi që gjitha kërkesat e lartpërmendura i përshtaten kompanive të caktuara dhe kufizohet konkurrenca.

Ju keni vepruar në kundërshtim me rregulloren nr.001/2022 për prokurim publik. Neni 25.6 i Rregullores për prokurim publik e parasheh qartë "Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Në këtë tender kërkesat e përcaktuara nga ju nuk janë proporcionale me objektin e kontratës dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit por janë kërkesa shumë më të mëdha se sa vlera dhe natyra e kësaj kontrate dhe janë kërkesa të panevojshme.

Neni 25.4 i Rregullores për prokurim publike parasheh qartë "Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme" do të nënkuptoj në lidhje me: a. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe b. përdorim të drejtë të fondeve publike.

Krejt në fund, kur kemi parasysh të gjitha faktet dhe dëshmitë që u përmendën më lartë dhe kërkesat favorizuese/diskriminuese, ju njoftojmë se nëse nuk ndryshohen këto kërkesa, ne nuk do të ndalemi me këtë kërkesë për rishqyrtim por do të vazhdojmë procedurat ligjore edhe në institucionet tjera administrative por njëkohësisht më pastaj këto veprime dhe këto kërkesa do ti denoncojmë në organet

*tjera kompetente me qëllim që të njoftohen edhe institucionet tjera kompetente se në këtë rast ka kurdísje të plotë të këtij tenderi.*

*Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

#### **Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore**

Ne lidhje me dispozitën e shkelur për te cilat pretendon **"Construmax SH.P.K"**, Autoriteti Kontraktues hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. **Neni 1 (Qëllimi)** – sipas këtij neni AK është i obliguar qe të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Edhe pse nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite, AK ju njofton se ka publikuar Njoftimin për kontrate duke shfrytëzuar procedurën e kufizuar me qellim te sigurimit ne mënyrën me efikase me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike dhe konfirmon se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim janë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.
2. **Neni 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi)** - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuuese, gjë te cilën AK e ka respektuar, sepse ka publikuar Njoftimin për kontrate dhe ka përcaktuar të gjitha kërkesat minimale për kualifikim ne përputhje me dispozitat e LPP dhe Rregulloren e Prokurimit Publik dhe janë kërkesa drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.
3. **Neni 22 (Dosja e Tenderit)** – sipas këtij neni AK të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. AK konfirmon se nuk ka shkelur këtë dispozite sepse ne Dosje te tenderit- respektivisht ne dokumentet e para kualifikimit ka dhënë te gjitha informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse.
4. **Neni 28 (Specifikimi teknik)** - sipas këtij neni AK do ti parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Edhe pse nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite AK sqaron se për këtë procedure eshet aplikuar procedura e kufizuar dhe se ne fazën e pare, ne fazën e parakualifikimit (Dokumentet e parakualifikimit) nuk percaktohen specifikimet teknike. Specifikimet teknike dorëzohen tek OE ne faze e dyte.
5. **Neni 68 (Gjendja Ekonomike dhe Financiare)** – sipas këtij neni Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të parashtrojnë të dhëna për të treguar se ata i përmbushin kushtet minimale ekonomike dhe financiare të specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Edhe pse nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozite, AK ju njofton se ka përcaktuar të gjitha kërkesat minimale për kualifikim ne përputhje me dispozitat e LPP dhe Rregulloren e Prokurimit Publik dhe janë kërkesa drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.
6. **Neni 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale)** – percakton deshmite te cilat duhet ti dorezoj OE per te deshmuar permbushjen e kerkesave te percaktuara nga AK. Dispozita ku

referoheni i referohet dëshmisë që OE duhet të dorëzojë dhe jo kërkesave sepse ne përputhje me legjislacionin ne fuqi kërkesat minimale përcaktohen nga AK.

7. **Neni 71 (Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik)** – përcakton kushtet që duhet plotësuar në rast të grupit të OE. JU nuk keni dhënë asnjë argument se si është shkelur kjo dispozitë.
8. **Neni 17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik (Dosja e Tenderit)** - sipas këtij neni AK të përpilojë një dosje të tenderit që deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. AK konfirmon se nuk ka shkelur këtë dispozitë sepse në Dosje të tenderit-respektivisht në dokumentet e para kualifikimit ka dhënë të gjitha informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse.
9. **Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik (Kriteret e përzgjedhjes)** – përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë. AK konfirmon se ka përcaktuar të gjitha kërkesat minimale për kualifikim në përputhje me dispozitat e LPP dhe Rregulloren e Prokurimit Publik dhe janë kërkesa drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

**Për më tepër, Autoriteti Kontraktues sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit është përzgjedhur procedura e KUFIZUAR.**

*Sipas nenit 56 të LPP dhe nenit 47 të Rregullores së Prokurimit Publik:*

*Procedura e Kufizuar është një procedurë me dy faza, ku vetëm ata Operatorë ekonomik të cilët i plotësojnë kërkesat minimale, në lidhje me aftësinë teknike dhe profesionale, dhe kapacitetet ekonomike dhe financiare për të kryer një projekt, ftohen në tender.*

- a) **Në fazën e parë, fazën e Para-kualifikimit, të gjithë Operatorët ekonomik ftohen t'i dorëzojnë kërkesat që të marrin pjesë në procedurë. Autoriteti Kontraktues zgjedh Operatorët Ekonomik të cilët i plotësojnë kërkesat minimale të kriterëve të përzgjedhjes të specifikuar në njoftimin e kontratës.**
- b) **Në fazën e dytë, faza e dhënies së kontratës, vetëm Operatorët Ekonomik të zgjedhur lejohen të tenderojnë. Autoriteti Kontraktues fton Operatorët e zgjedhur Ekonomik t'i dorëzojnë tenderët dhe i vlerëson tenderët duke përdorur kriteret e dhënies të specifikuar në ftesën për tenderim.**

**Të gjithë kandidatët pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar duke demonstruar ose konfirmuar se kandidatët janë të përshtatshëm dhe i plotësojnë kërkesat minimale të kualifikimit, do të konsiderohen të para-kualifikuar dhe të përzgjedhur për të marrë një ftesë për tender, përveç nëse numri i kandidatëve të tillë kalon numrin gjashtë (6).**

**Nëse numri i kandidatëve të përshtatshëm që plotësojnë kushtet e përzgjedhjes është më i madh se maksimumi prej gjashtë (6), pikat e forta dhe dobësitë relative të aplikacioneve të këtyre kandidatëve duhet të rishqyrtohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderimit. Gjatë rishqyrtimit, Autoriteti Kontraktues do të marrë në konsideratë për rishqyrtim vetëm faktorët e publikuar në Njoftimin e Kontratës. Autoriteti Kontraktues mund të merr parasysh vetëm kriteret e kapacitetit financiar ose teknik si kritere shtesë.**

AK, respektivisht Ministria e Shëndetësisë, ka përzgjedhur për këtë aktivitet të prokurimit Procedurën e Kufizuar. Ministria e Shëndetësisë ka përcaktuar të gjitha kërkesat e kualifikimit në përputhje me

dispozitat e LPP dhe Rregulloren e Prokurimit Publik dhe janë kërkesa drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Kriterin e mëposhtëm, të cilin e kemi përcaktuar si kriter të RI-ekzaminimit, dhe të cilin ju e konsideroni si kriter diskriminues, është kriteri i cili do të aplikohet VETEM nëse pranohen me shumë se gjashtë (6) aplikacione të cilat përmbushin kriteret e kualifikimit të përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe në Dokumentet e Para-kualifikimit. Do të thotë janë kriteret të RI-ekzaminimit për të përzgjedhur 6 aplikacionet me të mira. Pra, në rast se pranojmë me shumë se 6 aplikacione, 6 aplikacionet me të mira do të përzgjedhin ato aplikacione që kanë numër më të madh të kontratave me vlerë të madhe. Dhe në rast se kemi dy ose më shumë operatorë ekonomik që kanë të njëjtin numër kontratash të përfunduara me vlerë të madhe përzgjidhen ato aplikacione që kanë numër më të madh të kontratave për ndërtimin e projekteve shëndetësorë të kategorisë QKMF ose më lartë (nuk përfshihen AMF ambulancat).

- i. Numri më i madh i kontratave me vlerë të madhe (mbi 500,000 Euro) të përfunduara me sukses, që plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik të përmendur nën pikën 8.1 më sipër;
- ii. Numri më i madh i kontratave për ndërtimin e projekteve shëndetësorë të kategorisë QKMF ose më lartë (nuk përfshihen AMF ambulancat).

**Shënim:** fillimisht zbatohet pika (i) dhe pastaj (ii) zbatohet në rast se dy ose më shumë operatorë ekonomik kanë të njëjtin numër kontratash të përfunduara me sukses sipas pikës (i).

Ne lidhje me argumentin tuaj se ky faktor është konfuz dhe është diskriminues pasi kontratat me vlerë të mëdha janë kontrata që parashikimi i tyre mund të jetë mbi vlerën e parashikuar mbi 500,000 euro mirëpo nuk do të thotë oferta të jetë mbi këtë vlerë, ku ne kemi disa raste që kontratat kanë qene të planifikuara mbi vlerën 500 mijë euro me nr prokurimi 511 mirëpo ofertat tona kanë qene nën vlerën 500 mijë euro, **Ministria e shëndetësisë sqaron se nuk ka konfuzitet në këtë kriter të ri-ekzaminimit sepse është e cekur qarte se kontratat me vlerë të madhe janë kontratat me vlerë mbi 500,000 Euro.**


Ne lidhje me argumentin tuaj se ky faktor edhe nuk e precizon se këto referenca a duhet të jënë brenda 3 viteve të fundit, **Ministria e shëndetësisë sqaron se kjo është e cekur qarte në këtë kriter të ri-ekzaminimit pasi që përcakton "Numri më i madh i kontratave me vlerë të madhe (mbi 500,000 Euro) të përfunduara me sukses, që plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik të përmendur nën pikën 8.1" dhe kriteri nr.1 tek pika 8,1 përcakton: "Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses projekte në fushën ndërtimit (objekte të kategorisë II sipas ligjit të Ndërtimit, respektivisht MMPH-04 2017-UA), në vlerë të përgjithshme jo më pak se 3 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar 3 (Tre) vjeçare duke filluar nga data e Njoftimit për Kontratë".**

Ne lidhje me argumentin tuaj, Duke u bazuar në këtë Vlerësim të aplikacioneve përpos që është kufizuar në objekte të kategorisë si QKMF, ky është kufizuar edhe në vlerën e kontratave që kanë shumën mbi 500,000 euro ku është në kundërshtim me nenin 69 të LPP-se citojmë paragrafin 4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënenëshkruara nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë; **Ministria e shëndetësisë sqaron se përveç faktit se Dispozita ku ju referoheni i referohet dëshmisë që OE duhet të dorëzojë dhe jo kërkesave sepse në përputhje me legjislationin në fuqi kërkesat minimale përcaktohen nga AK, dhe faktit se AK ka përcaktuar kriteret në përputhje me nenin 69 të LPP, ky kriter i ri-ekzaminimit ndërlihet me nenin 56.2.2. të LPP dhe nenin 47.17 të Rregullores së prokurimit publik dhe është në harmoni të plotë me nenin 56.2.2. të LPP dhe nenin 47.17 të Rregullores së prokurimit publik.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit